

BASHKIA MIRDITË

Në këtë numër të buletinit mujor, sjellim një përmbledhje të aktiviteteve kryesore të Bashkisë Mirditë, të zhvilluara gjatë muajit Gusht 2025.

Vizitë e Delegacionit të Konfederatës së Sindikatave të Austriës në Bashkinë Mirditë.

Më datë 29 gusht 2025, mirëpritëm në Bashkinë Mirditë, Delegacionin Austriak nga Konfederata e Sindikatave të Austriës (ÖGB), përfaqësuar nga z. Oliver Röpke dhe z. Markus Strohmaier, të shoqëruar nga përfaqësues të Konfederatës së Sindikatave dhe Federatatës së Sindikatave të Administratës Publike dhe Shërbimit Civil në Shqipëri.



Gjatë takimit me Kryetarin e Bashkisë, z. Albert Melyshi, u diskutua mbi organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor, sfidat sociale të rajonit dhe shkëmbimi i përvojave për menaxhimin e shërbimeve vendore.

Po ashtu, u shqyrtuan mundësitë për të zhvilluar bashkëpunime ndërinstytucionale, përfshirë dhe binjakëzimin e Bashkisë Mirditë me një bashki nga veriu i Austriës, me karakteristika të ngjashme.

Ky takim vjen si një konfirmim i marrëdhënieve të mira dhe bashkëpunimit me miqtë tanë nga Austria, duke forcuar lidhjet kulturore dhe sociale ndërmjet dy vendeve.

Takim diskutues me stafin e UNDP, për projektin ReLOaD3.

Më datë 25 gusht 2025, në ambientet e Bashkisë Mirditë u zhvillua takimi diskutues me stafin menaxhues nga UNDP, në kuadër të projektit ReLOaD3, ku Bashkia Mirditë është shpallur fituese.

Gjatë takimit u diskutuan hapat ligjorë për formalizimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet UNDP dhe Bashkisë Mirditë, i cili pritet të nënshkruhet gjatë muajit shtator.

ReLOaD3 është një projekt i zbatuar nga UNDP dhe i financuar nga Bashkimi Evropian, që synon forcimin e demokracisë vendore përmes bashkëpunimit të pushtetit vendor me organizatat e shoqërisë civile dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Pas nënshkrimit të Memorandumit, do të përcaktohen fushat prioritare vendore, mbi të cilat do të hapen thirrjet publike për organizatat e shoqërisë civile.



ANSAMBLI MIRDITA

performon në San Cosmo Albanese, Itali.



Artistët e Ansamblit “Mirdita” morën pjesë në festivalin tradicional “La Sagra del Fico” në komunën San Cosmo Albanese, Itali.

Përmes këngëve dhe valleve popullore, ata dhuruan emocione të veçanta për publikun vendas dhe vizitorët e shumtë.



Kryetari i komunës San Cosmo Albanese, z. Damiano Baffa, i dorëzoi Ansamblit “Mirdita” emblemën e komunës, si shenjë mirënjohjeje dhe respekti për pjesëmarrjen e tyre dhe për përkushtimin në ruajtjen e traditave tona kulturore.

Pjesëmarrja e Ansamblit ‘Mirdita’ vjen si rezultat i binjakëzimit të Bashkisë Mirditë dhe komunës San Cosmo Albanese, një marrëveshje që synon të forcojë shkëmbimet kulturore, ekonomike dhe sociale mes dy komuniteteve.

Bashkia Mirditë falenderon komunën San Cosmo Albanese për mikpritjen dhe bashkëpunimin, si dhe shpreh përkushtimin për të vijuar projekte të përbashkëta që ruajnë dhe promovojnë identitetin tonë kulturor.

Shkolla Profesionale “Shën Jozefi Punëtor”, model suksesi në arsimin profesional.

Bashkia Mirditë ka nderuar me Certifikatë Mirënjohjeje për përkushtimin ndaj Arsimit Profesional në Shqipëri Z. Tobias Schmid, Drejtor i Qendrave Profesionale pranë Dhomës së Zejtariisë së Dortmundit, Z. Franc Musolli, Koordinator i projektit PAP për Shqipërinë dhe Etërit Somaske, për bashkëpunimin dhe angazhimin shumëvjeçar në mbështetje të arsimit profesional në Shkollën “Shën Jozefi”.



Ky vlerësim vjen si shenjë falenderimi dhe respekti nga Bashkia Mirditë, për kontributin konkret, të vazhdueshëm dhe vizionar në formimin profesional të të rinjve dhe fuqizimin e arsimit profesional në rajon.

Përmes bashkëpunimit me aktorë ndërkombëtarë dhe partnerë të përkushtuar, si Dhoma e Zejtariisë në Dortmund dhe projektet mbështetëse si PAP - Shqipëri, financuar nga Ministria Federale e Bashkëpunimit Ekomomik dhe Zhvillim (BMZ) është krijuar një model suksesi që ndikon pozitivisht në jetën e shumë të rinjve.



Infrastruktura rugore



Terreni malor në zonën tonë e bën mirëmbajtjen e rrugëve një nevojë të vazhdueshme.

Çdo ditë vijon puna për ndërhyrjet e nevojshme, me qëllim lehtësimin e lëvizjes dhe përmirësimin e infrastrukturës.

Kanë përfunduar punimet e mirëmbajtjes së rrugës së fshatit Geziq, ndërsa aktualisht po punohet në fshatin Hebe, Njësia Administrative Fan, si dhe në fshatin Zajs, Kurbnesh.





Në prag të fillimit të vitit të ri shkollor, Bashkia Mirditë ka ndërmarrë një sërë ndërhyrjesh në institucionet arsimore.

Janë kryer riparime dhe lysterje të pjesshme të ambienteve shkollore, si edhe është bërë dezinfektimi i plotë i godinave.

Këto masa kanë për qëllim sigurimin e higjienës dhe kushteve sa më të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor, duke garantuar një ambient të shëndetshëm e të pastër si për nxënësit, ashtu edhe për stafin pedagogjik.



Ambasadori i Shqipërisë në Sllovaki, vizitë në Mirditë.

Mirëpritëm në Mirditë Shkëlqesinë e Tij, z. Arten Hanku, Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Republikën Sllovake.

Gjatë takimit me kryetarin e bashkisë Mirditë z. Albert Melyshi, u diskutuan mundësitë për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Mirditë dhe institucioneve vendore europiane.

Një nga temat kryesore ishte nisma për binjakëzimin e Bashkisë Mirditë me Bashkinë Pezinok, Sllovaki, e cila pritet të finalizohet në muajin shtator.



Kryetari i Bashkisë Mirditë z. Melyshi falenderoi Ambasadorin Hanko për vizitën dhe mbështetjen, duke e vlerësuar këtë si një hap të rëndësishëm drejt bashkëpunimit konkret dhe zhvillimit të përbashkët.



Koncerti i Emigrantëve.

Më 18 gusht 2025, në sheshin Abat Doçi Rrëshen u zhvillua koncerti festiv i Ansamblit "Mirdita", organizuar nga Bashkia Mirditë, kushtuar vëllezërve dhe motrave emigrantë.

Qytetarë të shumtë u mbledhën për të shijuar këngët dhe vallet tradicionale të interpretuara nga artistët e Ansamblit Mirdita.



Aktiviteti solli një atmosferë festive për të gjithë të pranishmit, duke dëshmuar vlerën e ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë sonë kulturore.

“Investo në Mirditë”.



Bashkia Mirditë, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, organizoi aktivitetin “Investo në Mirditë” – një thirrje për bashkëpunim, e fokusuar në zhvillimin e aseteve në pronësi të Bashkisë Mirditë, në funksion të rritjes ekonomike dhe turizmit.

Aktiviteti bashkoi mirditorë nga brenda vendit dhe diaspora, sipërmarrës dhe përfaqësues të institucioneve. Takimi u hap nga Kryetari i Bashkisë Mirditë, z. Albert Melyshi, i cili përshëndeti të pranishmit dhe theksoi qasjen e bashkisë ndaj investitorëve:

– “Jemi këtu për të mbështetur çdo iniciativë që sjell zhvillim ekonomik dhe vende pune për qytetarët tanë”.

Z. Nikolin Jaka bëri thirrje për shfrytëzimin e potencialit të Mirditës si zonë me mundësi reale investimi, duke garantuar mbështetje logjistike dhe profesionale nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë për çdo sipërmarrës.



Dom Gjergj Meta shprehu rëndësinë e ruajtjes së mjedisit, duke theksuar se zhvillimi duhet të jetë i qëndrueshëm dhe i ndërtuar mbi vlera afatgjata për komunitetin.

Përfaqësuesi i Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, Z. Spartak Harizi, prezantoi skemat e mbështetjes financiare për bizneset dhe fermerët, duke shpjeguar mënyrat konkrete të aksesimit të fondeve për zhvillim në bujqësi dhe turizëm.

Z. Kol Gjoka, Konsull Nderi i Shqipërisë në Gjermani, nënvizoi rolin thelbësor të diasporës si një faktor kyç në zhvillimin ekonomik të vendit.

Në vazhdim, stafi i Bashkisë Mirditë solli një panoramë të qartë mbi atraksionet turistike të Mirditës, skemat e granteve ku mund të aplikojnë bizneset, procedurat ligjore për investime, si dhe nismën “Paketa e Maleve” që synon të krijojë mundësi të reja për zhvillimin e turizmit malor.



Z. Rigers Kacorri ndau vizionin për të ardhmen e industrisë agropërpunuese në Mirditë duke theksuar se :

– “Mirdita ka çdo gjë që i duhet për të qenë një qendër e fuqishme e prodhimit dhe turizmit rural. Duhet vetëm të besojmë dhe të punojmë së bashku për ta arritur”.

Takimi vijoi me diskutime të hapura dhe konstruktive mbi sfidat që përballen sipërmarrësit lokalë, si dhe mbi mundësitë për përmirësim dhe rritje të investimeve në zonë.

Ky aktivitet përbën një hap të rëndësishëm drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe rritjes së bashkëpunimit mes komunitetit, sipërmarrësve dhe bashkisë Mirditë.

Rikthimi që frymëzon: Historia e Bajron Nikollit në Katund të Vjetër, Mirditë.



Këtë muaj, rubrika "Hapësira për Zërin e Komunitetit" hapet me shembullin e Bajron Nikollit – që flet për rikthimin e tij në Mirditë.

Në moshën 14-vjeçare, Bajroni u largua nga Katundi i Vjetër, Rubik, për të ndjekur ëndrrën e një të ardhmeje më të mirë në Itali.

Si shumë të rinj shqiptarë, ai u përball me sfida të shumta: mësimi i një gjuhe të huaj, përshtatja me kulturën e re dhe ndërtimi i një jete të qëndrueshme përmes arsimimit dhe punës.

Italia do të bëhej shtëpia e tij për gati dy dekada – një vend ku ai u rrit profesionalisht dhe njohu nga afër vlerat e mikpritjes dhe zhvillimit të turizmit. Pikërisht këto përvoja, për Bajronin, do të ktheheshin në motivimin kryesor për t'u rikthyer në vendlindje.





Në vitin 2020, në kulmin e pasigurive që solli pandemia globale, Bajron Nikolli mori vendimin për tu kthyer në Mirditë.

Shtëpia e vjetër e familjes në Katund të Vjetër u shndërrua në themelin e një ëndrre të re – **“Baven-Toven Naturae”**, një hapësirë mikpritjeje ku ndërthuren tradita, natyra dhe vizioni për zhvillimin rural.

Rruga drejt realizimit nuk ishte aspak e lehtë. Mungesa e infrastrukturës, energjisë elektrike, terreni i vështirë dhe kostot e larta e kthyen projektin në një sfidë të madhe. Shumëkush i tha se po shpenzonte kot, por ai nuk u dorëzua.

Sot, pas disa vitesh punë e përkushtimi, “Baven-Toven Naturae” pret turistë nga Holanda, Gjermania, Belgjika, Franca dhe më gjerë. Vizitorët nuk vijnë vetëm për të fjetur, por për të përjetuar një eksperiencë autentike: natyrën e egër dhe të bukur të Mirditës, shijet tradicionale dhe mikpritjen e ngrohtë që është pasuria më e çmuar e këtij vendi.

Turizmi është një shans i madh për komunitetet rurale, dhe Mirdita i ka të gjitha: ujëvara, shtigje malore, histori të pasura e mbi të gjitha – njerëzit. “Ajo që kërkojnë sot vizitorët nuk është thjesht një destinacion, por një energji shëruese dhe njerëzore,” thotë Bajroni.

Për të, ky rikthim nuk është vetëm një histori personale suksesi, por një thirrje për të gjithë të rinjtë: **Merrni kurajon dhe sfidoni çdo “jo” dhe rrymë pesimiste. Ndërtoni diçka me zemër në Mirditë.**

Zëri i komunitetit

Ke një histori për të ndarë?

Në çdo cep të komunitetit tonë ka njerëz që punojnë dhe ndërtojnë me përkushtim.

Nëse je një prej tyre dhe dëshiron të ndash përvojën tënde frymëzuese, rubrika "Hapësira për Zërin e Komunitetit" është për ty.

Na kontakto në:
info@bashkiamirdite.gov.al
+ 355 216 22233

Bëhu pjesë e buletinit të Bashkisë Mirditë me historinë tënde – sepse shembujt pozitivë meritojnë të dëgjohen.